



N.T.P. "Zico TV"
Pronare – Rafete Memini
PAMU Zico TV
Rr/ Skenderbeu, Nr.32
Gjilan

Ref: 1708/849/LIC/ni

VENDIM

për miratimin e kërkesës për ndryshimin e skemës programore të Zico TV (Parashtruesi i Kërkesës), me seli në Gjilan

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Zico TV është Ofrues i Shërbimit Medial Adiovizual i cili është i licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave për të ofruar programe televizive përmes operatorëve të shpërndarjes me seli në Prishtinë. Zico TV është pajisur me licencë të KPM-së me datën 15 dhjetor 2008.
3. Më datën 16 maj 2016, Zico TV ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e skemës programore, si dhe plotësimin e formave sipas rregullorave të KPM-së, përfshirë edhe pagesën prej 100.00 Euro që parashihet me nenin 7, të Rregullores për Nivelin e Tarifës Vjetore të Licencës (KPM - 2014/03).

Arsyetimi

4. Neni 14, paragrafi 1, i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së përcakton:

"I Licencuari duhet që në transmetimet e veta, si një nga kushtet e Licencës, t'i përmbahet formatit dhe strukturës së përgjithshme të programit në bazë të të cilit i është dhënë Licenca dhe e drejta e përdorimit të spektrit të frekuencës. Dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me këtë mund të rezultojë deri në anulimin e Licencës".

5. Ndërsa Neni 14, paragrafi 2, i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së përcakton:

“I Licencuari obligohet që paraprakisht ta njoftojë me shkrim KPM-në lidhur me propozimin për ndryshime të mëdha të tipit ose burimit të programeve të dhëna në Pjesën 3 të Licencës ose të propozimit të heqjes së një përbërësi të formatit të licencuar. KPM-ja do ta njoftojë të Licencuarin me kohë, në rast se këto ndryshime të propozuara përputhen me interesat publike në bazë të të cilave i është dhënë Licenca, dhe nëse ato janë të tilla, do të ndryshojë Pjesën 3 të licencës së transmetimit në përputhje me kërkesën e të licencuarit.”

6. Ndërsa Neni 2, i Pjesës së tretë të licencës së KPM-së - Formati i Programit, thekson:

“Nga i Licencuari kërkohet që të njoftojë paraprakisht KPM-në për ndryshime të rëndësishme të cilat ai i propozon t'i bëjë në formatin e programit siç është përcaktuar në Pjesën 3 të Licencës. KPM-ja do ta njoftojë me kohë të Licencuarin nëse këto ndryshime të propozuara janë në përputhje me interesat publike në bazë të të cilave i është dhënë Licenca e parë, dhe nëse ato janë të tilla, KPM do të ndryshojë Pjesën 3 të Licencës në përputhje me kërkesat e të licencuarit.”


7. Komisioni konstaton se, kërkesa për ndryshimin e skemës programore është e kompletuar. Parashtruesi i Kërkesës ka ofruar informacione të qarta lidhur me ndryshimet e segmenteve programore si dhe ka kryer pagesën e tarifës administrative për ndryshime në licencë në vlerë prej njëqind (100) eurove, e përcaktuar me Rregulloren KPM - 2017/03.
8. Komisioni i KPM-së konstaton se, ndryshimet e propozuara në skemën programore të Zico TV, duke kaluar nga një skemë programore me përmbajtje tematike në program me përmbajtje gjeneralistike, janë ndryshime në shërbim të interesit publik.
9. Komisioni konsideron që, kërkesa e parashtruar është e kompletuar në pajtim me Procedurat e KPM-së për ndryshim të skemës programore, dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

10. Komisioni në takimin e tij të mbajtur me 22 shtator 2017, merr vendim për miratimin e kërkesës së OSHMA Zico TV, për ndryshimin e skemës programore, sipas kërkesës.

Lëshimi i Vendimit

11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



26.09.2017

datë